



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosovo  
Civil Aviation Authority of Kosovo

Nr. 16/ZDP/VE/2017

Datë: 22 dhjetor 2017

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, 10 shkurt 2016, ("Rregullorja") dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 28 prill 2014),

Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

### VENDIM

1. Përcaktohet tarifa njësi terminale për vitin 2018 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 378 EUR.
2. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) për shërbimet terminale të navigacionit ajror që ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari") duke filluar nga data 1 janar 2018.
3. Ky Vendim hyn në fuqi më 1 janar 2018.

### ARSYETIM

Duke marrë parasysh që:

- Autoriteti i Aviacionit Civil ka përfunduar shqyrtimin rregullator të propozimit të ASHNA-s për koston finale të ofrimit të shërbimit gjatë vitit 2018 dhe përcaktimin final mbi këtë kosto e ka bërë përmes Vendimit të tij nr. 15/ZDP/VE/2017 dt. 7 dhjetor 2017; dhe
- ASHNA ka kryer procesin e obligueshëm të konsultimit me kompanitë ajrore në periudhën 6-27 nëntor 2017 për propozimin e tarifës njësi terminale për vitin 2018;

Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Prishtinë, 22 dhjetor 2017



**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtore i përgjithshëm

### Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur mund të ngritë padi për konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente 30 ditë nga pranimi i këtij Vendimi. Ngritja e padisë nuk e pezullon ekzekutimin e këtij Vendimi.

Iu dërgohet:

- Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror
- Ministrit të Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, Ministria e Financave
- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"